

## GJOVALIN SHKURTAJ

**RRETH NDRYSHIMEVE NË GJUHËN E FSHATIT TË SOTËM  
TË VERIUT (SIPAS VËZHGIMEVE NË ZONËN  
E KOPLIKUT, RRETHI I SHKODRËS)**

Dihet se historia e gjuhës është e lidhur ngushtë me historinë e shoqërisë, prandaj ligjet e zhvillimit të një gjuhe mund të kuptohen vetëm duke i parë në lidhje me historinë e popullit që e flet, i cili është krijuesi dhe bartësi i saj. Kështu p.sh. ndarja dialektore e gjuhës shqipe është pasojë e rrugës historike nëpër të cilën ka kaluar populli ynë: ndarja dhe copëzimi krahinor sipas fiseve, feudeve a principatave, sipas maleve a bajraqeve, përçarja në fe të ndryshme dhe robërimi shumëshekullor prej pushtuesve të huaj kanë lënë gjurmë të thella edhe në gjuhë.

Gjuhësia marksiste ka shpjeguar se dialektet e një gjuhe veçohen, ose përkundrazi afrohen e njësohen në varësi nga komunikimi midis kolektivave përkatëse, nga shtrirja dhe zgjatja e këtij komunikimi. Mund të thuhet se ndërsa zanafilla e dialekteve është e lidhur, me izolimin pak a shumë të madh të përfaqësuesve të tyre në të kaluarën, rrafshimi dhe shuarja e dallimeve dialektore vinë nga zgjerimi i komunikimit midis përfaqësuesve të dialekteve të ndryshëm njeri me tjetrin dhe sidomos nga bashkëveprimi i tyre me gjuhën letrare kombëtare, i cili realizohet plotësisht vetëm në periudhën e socializmit. Një dëshmi e qartë për këtë është zhvillimi konvergjues i dialekteve dhe i të folmeve të gjuhës sonë. Vrojtimet gjuhësore tregojnë se nga dita në ditë dallimet dialektore po vinë duke u rrafshuar.

Në këtë artikull, duke u mbështetur në vëzhgimet e bëra në zonën e Koplikut (rrethi i Shkodrës) në qendrat Koplik, Bajzë, Zagorë, do të përiqemi të japim, në vija të përgjithshme, ndryshimet në gjuhën e fshatit në pasojë të zhvillimit ekonomik e kulturor, të ndikimit nga gjuha letrare<sup>1</sup> dhe të bashkëveprimit me të folmet e tjera, sidomos me të folmen e qytetit të Shkodrës. Kufizimin vetëm në këtë zonë e bëjmë për dy arsye: së pari, sepse nuk mund të flisnim këtu për mbarë të folmet e Malësisë së Madhe e të Rranxave, duke qenë se ka pika skajore si Këlmendi, Boga, Reçi, Lohja etj. të cilat nuk janë eksploruar ende; së dyti, sepse brenda krahinës së Mbishkodrës (duke përfshirë çka quhej Malësi dhe Rranxa<sup>2</sup>), zona e Koplikut, duke qenë me terren fushor, më afër qytetit të Shkodrës dhe e lidhur me të prej kohësh me rrugë automobilistike, pas çlirimit, pati kushte më të përshtatshme për të ecur më përpara sesa zonat malore, si në pikëpamje ekonomike ashtu edhe kulturore.

1) Në këtë kumtesë, termin gjuhë letrare do ta shtrijmë edhe mbi «thjeshtligjërimin».

2) Zona e Mbishkodrës, duke filluar nga Gruemira e Grizha në jug e deri fare në Veri (Kelmend) përbën një njësi të vetme etnografike e gjuhësore. Në të kaluarën ajo ndahej në dy pjesë: Malësia (e njohur me emrin Malësia e Madhe) ku hynin: Hoti, Gruda, Triepshi, Kelmendi, Kastrati e Shkreli dhe Rranxat, ku hynin: Kopliku, Grizha, Lohja, Reçi, Rrjollë.

Gjatë njëzetepesë vjetëve të periudhës pas çlirimit, fshatrat e Koplikut kanë pësuar një transformim të thellë socialist. Masat e rëndësishme që janë marrë nga partia dhe qeveria janë për t'i ardhur në ndihmë fshatit, për ta bërë atë si qytetin, duke u kujdesur jo vetëm për zhvillimin e ekonomisë, por edhe për rritjen e nivelit ideopolitik e kulturor të masave të gjëra të fshatarësisë, kanë dhënë e po japin rezultate shumë të mira. Si pasojë e këtyre masave kanë ndryshuar e po ndryshojnë gjithnjë e më shumë fshatrat e kësaj zone, prirë gjithnjë nga e reja, nga revolucionarizimi i gjithë jetës së tyre. Sot, të gjithë djemtë dhe vajzat e kësaj zone mbarojnë shkollën tetëvjeçare. Që prej 7 vjetësh në Koplík është çelë edhe një shkollë e mesme e arësimit të përgjithshëm, ku ndjekin mësimet një pjesë e mirë e atyre që mbarojnë tetëvjeçaren. Një armatë e tërë mësuesish, agronomësh, mjekësh, veterinerësh etj. vendës, pasi kanë kryer studimet janë kthyer e punojnë në fshatrat e veta, duke kontribuar në përparimin e lulëzimin e ekonomisë e të kulturës socialiste të fshatit. Që në vitin 1957 në mbarë këtë zonë përfundoi kooperimi i bujqësisë, faktor që ka siguruar triumfin e marrëdhënjeve socialiste në fshat që ka hapur shtigje të reja për zhvillimin dhe përparimin ekonomik e kulturor. Jeta në kooperativë, me organizimin e mbledhjeve, me krentimin e festave dhe të datave përkujtimore etj. krijon kushte të mira edhe për zhvillimin e fjalës publike: mbahen referate e raporte, bëhen pyetje e diskutime. Kemi vërejtur se në këto raste diskutuesit përipiqen të flasin me kujdes, përdorin mjaft fjalë e terma të gjuhës letrare, të marra sidomos nga stili i publicistikës, duke u rrekur të bëjnë një krehje të fjalëve dhe të trajtave fonetike ngushtësisht nëndialektore.

Në mbledhjet e ndryshme të komiteteve të rinisë, të organizatave bazë të rinisë dhe në mbledhjet e gjëra të asambleve të kooperativave, ne kemi pasur rastin të dëgjojmë «gjysëm dialekte» origjinale ku gërshetohen tiparet e të folurit letrar që përvetësohet me veçoritë gjuhësore të ruajtura nga e folmja e vendit. Shkalla e përzjerjes përcaktohet nga faktorë jashtëgjuhësorë si: shkalla e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në fshatin përkatës, largësia nga qyteti dhe lidhjet e kontaktet që fshati ka me të; moshja e atij që flet, arësimi dhe funksioni që kryen ai në kooperativë, lëvizjet e tij jashtë fshatit: në ushtri, në aksione, për specializim etj. Vrojtimet e bëra në këtë zonë, në njerëz moshash të ndryshme, që nga klasa e parë e shkollës fillore e deri tek më të moshuarit, tregojnë se ndryshimet dhe zhvillimet më të mëdha gjuhësore i përkasin sferës së leksikut. Kjo ngjet, ngaqë leksiku i gjuhës është i lidhur shumë ngushtë me të gjithë veprimtarinë e njeriut, me të gjitha sferat e punës së tij.

Zhvillimi i ekonomisë së kooperativës, futja në punë e mekanikës bujqësore të përparuar e vë fshatarin në kontakt me mjete dhe vegla të reja, të panjohura më parë. Së bashku me mënyrën e përdorimit dhe me dobinë e tyre ai njuh edhe emërtimin e tyre. Kështu po zënë vend në fjalorin aktiv të kooperativistëve sidomos në brezin e ri fjalë që emërtojnë mjete dhe vegla të reja pune si dhe veprimet që kryhen me to: a) nga mekanika bujqësore: *diskqe, diskoj, diskim, plug, plugoj, plugim, traktor, autokombaj, zitor, makin silazhit, silazhoj, silazhim, kultivator, kultivoj, kultivim* etj. Këtu mund të përmenden edhe emrat e traktorëve e të makinave të ndryshme: *dete, ofër, kede, gas, skod, zis*, etj.

b) plehra dhe insekticide të ndryshme që përdoren në bujqësi: *pleh kimik, nitrat, superfosfat, granoson, gastrofok* etj.

Në çdo fshat vatrën dhe shtëpitë e kulturës, zhvillojnë një aktivitet

të madh. Në to gjenden biblioteka të pasura me letërsi politike, teknike e artistike, salla lodrash, salla shfaqjesh etj. Të rejat dhe të rinjtë organizojnë vetë shfaqje estrade, vënë në skenë vepra dramatike. Çdo vit organizohen edhe olimpiadat teatrale në bazë zone a rrethi. Herë pas here në fshat vinë edhe trupa artistike nga qyteti. Nga të gjitha këto po hyjnë në përdorim shumë fjalë e terma të kulturës: *teatër, estrad, dram, skeç, recitim, parodi, rrefren, solist, rapsod, konferencjer, balet, artist, aktor, rroman, novel, tregim, poezi, shkrimtar* etj.

Një përhapje të gjerë ka marrë terminologjia sportive: *spartakiad, neshje, voliboll, futboll, munje, tërheqje litarit, finale, korrne, gol, gola-verazh* etj.

Të shuma janë veçanërisht fjalët e termat që lidhen me jetën politike-administrative dhe ekonomike-shoqërore të fshatit:

a) nga sfera politike-administrative: *socializëm, komunizëm, imperia-lizëm, revizionizëm, OKB, burrokraci, vija e masave, lufta e klasave, qar-kullim i kuadrit, kshilli popullor, kshilli i frontit, përgjegjës i blegtoris, shtabi i brigadës.*

b) nga sfera ekonomike-shoqërore: *blegtori, prodhim, realizim, tej-kalim, norm, ditpune, plan pune, grafik, kan emulacionit, gar, shpallje, fletrrufe, llogarit, magazinjer, SeMeTe, NeTeLAP, NeTeLUS.*

Pas çlirimit, veçanërisht që nga kooperimi e këtej, është ngritur shumë edhe mirëenja e fshatarësisë së këtyre anëve. Me të ardhurat që nxjerrin nga puna në kooperativë, fshatarët kanë arritur të ndërtojnë banesa të reja, kanë përmirësuar kushtet e fjetjes e të ushqimit dhe dita ditës po përvetësojnë mënyrën e jetesës së kulturuar, njësoj si në qytet.

Lidhur me këtë ndryshim janë përhapur shumë emërtimet e ndryshme të veshjeve dhe të orentive shtëpiake të reja: *triko, çorap neilonit, fun, bluz, tuta, kordel, dok, kostum, xhaket, xhaketin, komplet, pjat, piru, mbules tavolinet, komo, rradio, shporet* etj.

Krahas me futjen e fjalëve të reja në gjuhën e fshatit ndodh edhe procesi i përkundërt d.m.th. dalin nga përdorimi ose rrallohen shumë fjalë, tashmë të vjetëruara.

Përveç historizmave si *qitap, beg, ag, kryeplak* etj. kanë hyrë në rru-gën e zhdukjes ose kanë ngushtuar përdorimin e tyre fjalë si: *bucak, blud, lug drunit, sahan remit, gërrçak, skrop, kaçimak, bajrak, parmen* etj.

Në brezin e ri një përdorim mjaft të kufizuar kanë tashti edhe emër-timet e veshjeve tradicionale, si *çakçir, xhublet, xhamadan, jelek, kopic* etj. gjë që lidhet me faktin se këto lloj veshjesh janë zëvendësuar me rroba të tjera të reja, më të lehta e më të përshtatshme për punë; kështu që ato kanë mbetur vetëm për ditë festash kombëtare, për dasma, festivale etj. Shumë janë kufizuar fjalët që i përkisnin sferës fetare, goftë të besimit kristian, goftë muhamedan. Puna e madhe sqaruese dhe sidomos lufta re-volucionare që bëhet në fshat kundër besimeve të kota, riteve dhe cere-monive fetare kanë dhënë rezultate të mira. Mund të themi se tashmë janë bërë arkaizma fjalët *xhokua, lter, kem, rrfim, kubim, oste, sakramen, pashk, parriz, nies, nat e madhe, teravi, tyrbe, me fal sabahin, me fal baj-ram*, etj.

Si konkluzion të përgjithshëm për ndryshimet në leksikun e gjuhës së fshatit mund të themi këto gjëra:

I. Për futjen e fjalëve dhe të termave të reja, të panjohura më parë, ndikojnë tre faktorë:

1) *gjuha letrare*, e cila përhapet nëpërmjet teksteve shkollore, letër-sisë artistike, politike e shkencore, shtypit dhe radios.

2) *gjuha popullore me bazë dialektin e jugut* e cila ndikon në gjuhën e fshatit nëpërmjet të folurit të kuadrove të ndryshëm të ardhur nga viset e jugut, të aksionistëve, ushtarëve etj. të cilët qëndrojnë në fshat për një kohë të gjatë.

3) *E folmja e qytetit të Shkodrës*, e cila ushtron ndikimin e vet në të folmet e fshatit nëpërmjet arësimitarëve, mjekëve, aksionistëve (mujorë a vjetorë) që punojnë e banojnë në fshat, si dhe nëpërmjet vajtjeve të tjera të grupeve të ndryshme nga fshati në qytet dhe anasjelltas.<sup>3</sup>

II. Për shumicën e fjalëve të reja<sup>4</sup> dihet afërsisht edhe «ditëlindja» e tyre. Kështu p.sh. fjalët që kanë hyrë në të folmen e këtyre fshatrave mbas çlirimit mund të ndahen në tre grupe:

1. Fjalë që kanë hyrë që gjatë Luftës nacionalçlirimtare dhe në vitet e para të çlirimit: *parti, partizan, komunist, çlirim, kshill, reforma agrare, tatim, çikvestrim, kolektiv* etj.

2. Fjalë që kanë hyrë gjatë periudhës së çlirimit deri në kooperim: *traktor, SMT, bujk përparimtar, fletdetyrim, tatim fitime, kuitanc, avanc, kulak, zgjedhje, fushata e zgjedhjeve, kandidat, shkolla shtatvjeçare, plani pesvjeçar* etj.

3. Fjalë që kanë hyrë gjatë periudhës që nga kooperimi (viti 1957) e tëhu: *kooperativ, brigadjer, brigad, skuadër, skuadërkomandant, bllok, parcel, asamble, kryellogaritar* etj.

III. Si për fjalët që hyjnë ashtu edhe për ato që zhduken (vjetërohen) duhet pasur parasysh se ekziston një dallim simbas moshës, d.m.th. përvetësimi i fjalëve të reja dhe rreshtja nga të vjetëruarat bëhet së pari nga brezi i ri dhe i mesmi, kurse në brezin e vjetër, fjalët e reja hyjnë më ngadalë, ndërsa të vjetëruarat vazhdojnë të gjëlljnë.

Nga ana tjetër, është për t'u përmendur se edhe brenda brezit të ri e të mesëm, përhapja e fjalëve të reja është e lidhur me faktorët jashtë-gjuhësorë, *arësimi, profesioni, lëvizjet jashtë fshatit* etj. Nga kjo pikëpamje, pa hyrë shumë ndër detaja, në fjalët e reja mund të dallohen tri shtresa:

1. Fjalë që tashmë janë futur plotësisht në përdorim dhe njihen nga mbarë folësit pa dallim nga moshë, arësimi, lëvizjet etj. Hyjnë në këtë grup fjalët shumë të përdorshme si *traktor, autokombaj, zitor, koprativ, brigad, brigadjer, skuadër, konferenc, estrad* etj.

2. Fjalët në të hyrë e sipër. Futen këtu fjalë e terma të kulturës të cilat njihen dhe përdoren kryesisht nga brezi i ri e nga persona të brezit të mesëm me shkollë ose me përvojë të gjërë e që kryejnë funksione drejtuese të ndryshme në fshat. Shumica e këtyre fjalëve hyjnë nëpërmjet gazetës, radios, letërsisë artistike e sidomos nëpërmjet shkollës: *tregim, roman, novelë, poet, shkrintar, universitet, fakultet, diplom, prapanik, bestytni, emision, radiopost* etj.

3. Fjalë që po futen duke luftuar me trajtat nëndialektore përgjegjëse të vendit: *mih — prashis, lvroj — plugoj, dves, pves — pyes, mide-stomak, i shmakt, i shmabt — i majt, rrej — gënjej, knoj libra — lexoj libra, krye — kok, çini — pjat, fanel — xhup, dejt — dallnyshe, mëdër, mënër — sherbel, thi — derr, mallot — xhaket, kollomoq — misër, kertolla — patate, torrogop — kazëm, çoban — bari, tàmël — qumsht* etj.

Në këtë grup ka raste kur fjala lokale me fjalën e marrë nga gjuha

3) Shkodra, ka qenë dhe vazhdon të jetë vendi ku malësorët zbresin për të bërë pazarin si dhe për të kryer nevoja të ndryshme, mjekimi etj.

4) Me «fjalë të reja» këtu do të kuptojmë ato fjalë që për nëndialektin në fjalë janë të reja, ndërsa në gjuhën letrare, ato ka kohë që s'janë më të tilla.

letrare kanë të njëjtën trajtë fonetike, por kuptime të ndryshme d.m.th. krijohen të ashtuquajturat dialektizma semantike të tipit *dërgoj* (fj. lokale) pi sisën një sisor i vogël ose një foshnjë dhe *dërgoj* (fj. e mbarë gjuhës) nis me njeri a me një mjet tjetër: Po kështu: *kjumsht* — (fj. lokale) — hirrë e zenë me tharm kosi. *qumsht* — (fj. e mbarë gjuhës) e cila po përhapet në vend të fjalës tamël.

*çpiki* (fj. lokale) — i heq hirrën djathit të posampiksuar.

*çpiki* (fj. e mbarë gjuhës), bëj një zbulim të rëndësishëm...

*mjet* (fj. lokale) — mur me dërrasa, me çatme etj, që ndan një odë nga tjetra.

*mjet-i* (fj. e mbarë gjuhës) — çdo gjë që hyn në punë për realizimin e një veprimi.

V. Pjesa më e madhe e fjalëve që në gjuhën e fshatit hyjnë si fjalë të reja, nuk janë të tilla në gjuhën letrare ose në dialektin prej nga janë marrë. P.sh. *përparoj*, *përparimtar*, *guximtar*, *gazmor*, *orar*, *realizoj*, *tejkaloj*, *llampë*, *portollampë*, *priz*, *spinë*, *tension* i *nalt* etj. përdorëshin prej kohësh në gjuhën tonë jo vetëm në toskërishten por edhe në të folmen e Shkodrës, mirëpo në këtë zonë kanë hyrë relativisht vonë.

Gjatë vëzhgimit që kemi bërë në këtë zonë, kemi nxjerrë edhe një serë ndryshimesh interesante nga fusha e gramatikës, më tepër në fonetikë. Për ndryshimet në fushën e gramatikës mund të thuhet se në gjendjen e sotme të këtyre të folmeve, nuk mund të flitet për zhvillime (evolucione) të vërteta, por për një prirje drejt trajtash të reja që hyjnë nëpërmjet shkollës, shtypit, radios, aksioneve, ushtrisë, etj. Trajtat e reja fonetike përqafohen nga brezi i ri i shkolluar, tek tuk edhe nga individë të brezit të mesëm, por kjo, me sa kemi konstatuar ne, të shumtën e herës është një punë e ndërgjegjshme, d.m.th. folësi me vetëdije përpiket të shmanget nga trajtat e ngushta të së folmes lokale për t'u shprehur më qartë e më kuptueshëm, në mënyrë «zyrtare» sepse ashtu e lypin rrethanat (mbledhje e gjerë, konferencë, mbërme tematike, shfaqje teatrale etj.). Është pikërisht kjo arsyeja që, përveç dallimit simbas brezave, i cili bie në sy më lehtë, bëjmë edhe një dallim tjetër simbas stileve, d.m.th. vlerësojmë rrethanat në të cilat kryhet të folurit. Kështu p.sh. ne kemi vënë re se në shkollë, në mbledhje, në shfaqje, në këngë e në recitime, po edhe në bisedë të zakonshme kur si bashkëbisedues është një kuadër nga qyteti ose një folës i dialektit jugor, përdoren trajta fonetike të marra nga gjuha letrare ose nga e folmja e qytetit të Shkodrës, ndërsa në bisedat që bëhen në familje, në arë, në rrugë etj. përdoren trajtat vendëse. Për të nxjerrë në pah ndryshimet fonetike që kanë pësuar këto të folme neve na duket e nevojshme të bëhet kjo ndarje:

1) Zhvillimi fonetik në fjalët e reja që kanë hyrë këto 25 vjet.

2) Zhvillimi dhe ndryshimi fonetik në fjalët ekzistuese (vendëse).

Në grupin e parë kemi të bëjmë me një luftë trajtash: të trajtës që ka fjala në gjuhën letrare kombëtare e cila përdoret nga brezi i ri dhe i mesëm e që po fiton, dhe të trajtës që ka pësuar ndryshime në gojën e brezit të vjetër, e cila sa vjen rrallohet e humbet.

Kështu p.sh. *rade* (b.v.) — *rradio* (b. ri), *sekletar* (b.v.) — *sekretar* (b. ri) *n'përgjesi* (b.v.) — *n'përgjithsi* (b.ri), *ckjaroj* (b.v.) — *sqaroj* (b. ri), *hasanble* (b. v.) — *asamble* (b. ri), *bregat* (b. v.) — *brigad* (b. ri), *skadër* (b. v.) — *skuadër* (b. ri), *rraspekt* (b. v.) — *rrespekt* (b. ri), *munci* (b. v.) — *mumsi* (b. ri), *ranci* (b. v.) — *ransi* (b. ri), *shatar* (b. v.) — *fshatar* (b. ri), *rroplan* (b. v.) — *arroplan* (b. ri), *gjansi* (b. v.) — *agjensi* (b. ri), *automike* (b. v.) — *atomike* (b. ri), *dantist* (b. v.) — *dentist* (b. ri), *korronel*

(b. v.) — *kolonel* (b. ri), *stalim* (b. v.) — *instalim* (b. ri), *kopedenc* (b. v) — *kompetenc* (b. ri), *korrel* (b. v.) *korjer* (b. ri), *kõt* (b. v.) — *kuot* (b. ri), *te-lifân* (b. v.) — *telefon* (b. ri) etj.

Në grupin e dytë procesi është mjaft i ndërlikuar, ka shumë luhajtje. Fitorja e trajtave të reja bëhet më vështirë dhe shumë më ngadalë se në grupin e parë. Në gjendjen e sotme të këtyre të folmeve, ndryshimet më të rëndësishme fonetike në fjalët ekzistuese janë:

1. Disa fjalë të cilat e kanë pasë theksin në rrokjen e parafundit, nën ndikimin e gjuhës letrare, në brezin e ri, dëgjohen më shpesh me theksin në fund: *veri-u*, *budallá*, *njeri-u*, *historí*. Pranë tyre, në brezin e vjetër dhe në bisedën e lirë nga brezi i mesëm hasen edhe trajtat *véri*, *budáll*, *nier*, *históre*.

2. Në fjalëzat proklitike të patheksuara, sidomos tek nyja të dhe tek parafjala në ku, si në mbarë fjalëzat proklitike, ka rënë ë-ja e patheksuar, vihet re prirja për të shtuar një e në vend të ë-së: *për te mbliedh*, *te mushkris*, *te hekrít*, *i ushqen te vegjlit*, *Nika përpelítej ne krevat* etj.

(Këtë fenomen e kemi vënë re kryesisht ndër nxënës të tetëvjeçares e të gjimnazit, sidomos gjatë përgjigjeve me zë rreth lëndës së mësuar në tekst).

3. Zbërthimi i e-së në ie përpara bashkëtingëlloreve palatale sa vjen e pakësohet. Brezi i ri, sidomos ata që tashti janë në tetëvjeçare ose në gjimnaz, përdorin pothuajse gjithnjë: *gjeli*, *qe*, *qeshi*, *qelbet*, *gjeta*, dhe jo *gjieli*, *qie*, *qieshi*, *qielbet* etj., karakteristikë më tepër në brezin e vjetër.

4. Togjet *ua* dhe *uo* paraqiten si pika më konservative, megjithatë edhe ata kanë pësuar disa ndryshime. Kështu p.sh. shumë fjalë të tipit *mësues* të cilat brezi i vjetër i shqipton me *uo*, *msuos*; në brezin e ri shqiptohen njësoj si në të folmen e qytetit të Shkodrës: *msūs*, *përcūs*, *kallzūs*, *ngacmūs*. Ndonjëherë sidomos në brezin e mesëm, këto fjalë shqiptohen me një si diftongoid *u°*: *msu°s*, *përcu°s*, *ngacmu°s*.

Edhe togu *ua* njanjëherë zëvendësohet me *u* ose *u°* p.sh. me *shoqnū*, *me plotsū*, *me takū*, *mou dobsu°*, *me korigju°* etj., por sot për sot më të shumta janë rastet kur ruhet *ua*-ja: *me lexua*, *me nigjua me propozua*, *me punua*, *me vizatua* etj.

5. Nga të tre rezultatet që ka dhënë asimilimi i grupeve *mb*, *nd*, *ng* (shih më sipër) zënë të përdoren dendur e bëhen pothuaj të gjithmbarshëm *m*, *n*, *η*. Nga brezi i ri dhe i mesëm tashmë dëgjohet gjithnjë: *mledhje*, *mlohet*, *munohem*, *ven*, *gjanrra*, *kaηg*, *lāη* etj. Nxënësit në shkollë nën ndikimin e gjuhës së teksteve si dhe në sajë të punës së mësuesve përdorin dendur edhe grupet e plota *mb*, *nd*: *asht i mbulluar*, *pëllumbi*, *këmbës*, *gjendet*, *vendosën* etj. Edhe në mbledhjet e ndryshme të fshatit kemi pasur rastin të vemë re se në referatet, raportet etj. përdoren dendur trajtat me *mb*, *nd*, *ng*: p.sh. *mbjellje*, *mbledhje*, *ndamje*, *ndërmarrje*, *ndryshime*, *ngutet*, *ngadal*, etj.

6. Brezi i ri i moshës shkollore, sidomos në përgjigjet në klasë përdor shpesh trajta të rotacizuara si: *dashuri*, *lumturi*, *truri*, *mushkрит*, kemi *mësuar*, *ka shkruar* etj.

Sot për sot këto trajta nuk kanë marrë edhe përdorim të përherëshëm, të qendrueshëm dhe mbeten, si të themi, një ndikim libresk i çastit, por ka edhe raste si *lumturi*, *dashuri*, *pikërisht*, *besnikri*, etj. ku trajtat me rotacizëm janë bërë të gjithmbarshme, për arsye se këto fjalë u përdorën rishtas duke u futur drejtpërdrejt nga gjuha letrare, nëpërmjet letërsisë artistike e teksteve shkollore.

7. Në klasat e larta të tetëvjeçares dhe në gjimnaz të Koplikut disa herë dëgjuam edhe trajta të marra nga gjuha letrare ku a-ja hundore gege zëvendësohet me ë: *përbëjnë, bëjnë*.

8. Grupi *g-j* (i ardhur nga *gl*) i cili në brezin e vjetër shqiptohet *g-jj*: *g-juha, g-jat, g-jadër, nig-joj*, etj. në brezin e ri e të mesëm dëgjohej si gj: *gjuha, i gjat, gjandër, nigjoj*. Më e theksuar është kjo në Koplik qendër. Të njëjtën rrugë po ndjek edhe grupi *kj* (i ardhur nga *kl*) i cili ka përfunduar në q: *qumsht, qaj, qumshtore*.

9. Nën ndikimin e të folmes së qytetit të Shkodrës, në disa fjalë vihet re se është shtuar kalimi i *h* në *f*: p.sh. *njof, shof, lef*, ndërsa siç e kemi vënë në dukje në punimin për të folmen e Kastratit<sup>5</sup> në këto të folme këto fjalë zakonisht përdoreshin në trajtën me *h*: *njoh, njeh, shoh, sheh, leh*.

10. Në disa fjalë të cilat në këto të folme kanë pasur trajtën me *b*: *bërza, bërgjigjem, bërziej*, ka prirje të shtrihen trajtat me *p* — njësoj si në gjuhën letrare: *përza, përgjigjem, përziej*.

11. Grupi (*p sh.*) në fjalë si *pshij, rrafsh, kapshoj, kapshat* ka prirjen të kalojë në fsh: *fshij, rrafsh, rrafshoj, kafshoj, kafshat*.

12. Trajtat e asimiluara të grupeve *tn, tm*, riplotësohen. Pra në vend të *pen a men, gjien, pame* etj. që hasen në brezin e vjetër brezi i ri përdor *mbetën a metën, gjetën, gjetme, patme* etj.

13. Njësoj si me *tn, tm* po ndodh edhe me *qn, gjn*. Trajtat e asimiluara *hojn, dojn, pojn; plejt, zojt*, në brezin e ri dëgjohej: *hoqën, dogjën, poqën, pleqt, zogjt* etj.

III. Ndryshimet në strukturën gramatikore janë shumë më të paka se sa në leksik dhe në fonetikë. Mund të themi se vërehen vetëm disa ndryshime të vogla në ndonjë pikë të lëkundshme, më tepër tek pronorët dhe disa trajta foljore.

Në monografinë tonë për të folmen e Kastratit<sup>6</sup> ne kemi vënë re se në sistemin e pronorëve përbënin interes jo vetëm ruajtja e disa trajtave të vjetra si *tit* «tend», *taj, tij* «tuaj» etj., por edhe futja e disa trajtave të reja të marra nga gjuha letrare dhe nga e folmja e qytetit të Shkodrës. Duke e ndjekur këtë fenomen edhe në të folmet e tjera të kësaj zone na rezultoi se trajtat e mësipërme janë kufizuar shumë dhe i hasim vetëm në brezin e vjetër, më tepër në Malësi. Në brezin e ri e të mesëm, nën ndikimin e teksteve, shtypit, radios, po edhe të folmes së qytetit të Shkodrës, po bëhen të gjithmbarshme trajtat *tan* (tand) për *tit, tuoj* për *tâj, taj, im* për *em, tim* për *tem, etj*. Nën ndikimin e të folmes së Shkodrës, po hyjnë, madje edhe trajta të gabuara pronorësh siç është p.sh. *jonë* për *ynë, kali jon* për *kali yn*. Është për të theksuar se, ashtu sikundër e vumë në dukje më lart për leksikun e fonetikën, përdorimi i këtyre trajtave të reja është i lidhur ngushtë me rrethanat e ligjëritimit, pra me stilin e të folurit. Trajta të tilla janë shumë të shpesha në mbledhje, në shfaqje, në përgjigjet e nxënësve në klasë etj. por janë mjaft të rralla, pothuajse sporadike në bisedën e lirë familjare.

Në sistemin foljor janë më interes këto ndryshime:

1. Trajtat e aoristit V. III nj. dhe shumë: *muor, muorën, duol-duolën, vuor-vuorrën, nxuorr-nxuorrën* etj. të foljeve me apofoni, nganjëherë zëvendësohen me trajtat letrare: *mori-morën, doli-dolën, vorri-vorrën, nxorri-nxorrën* etj.

5) Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kastratit*, «Studime filologjike», 2, 3, 1967.

6) Po ai, *Po aty*.

2. Trajatat e vetës së III njejës të së kryerës së thjeshtë me mbaresën *-u*: të foljeve me zanore, *shkou, punou, ndërto, përfunou* etj. po zëvendësohen me trajtat letrare me *-i shkoi, çliroi, zëvensoi, shkroi*.

3. E pakryera, në përgjithësi ruan trajtën e vet karakteristike me mbaresat *-shem, -she, -te, -shim, -shi, -shin*. Vihet re rrallimi i trajtave me mbaresat *-tesh, -ntesh, -shtesh*, të cilat hasen vetëm në brezin e vjetër. Po kështu trajtat e vetës së tretë: *bâte, punote, shkote, late, flete* etj. po zëvendësohen me trajtat e rregullta letrare: *punonte, shkonte, lante, flente*, etj. Nganjëherë sidomos nga nxënësit dëgjuam edhe trajtat si *blinte, flinte, nxirnin, ushtronin* etj. të cilat flasin për ndikimin e fortë të gjuhës letrare nëpërmjet teksteve shkollore.

4. Trajta e së ardhmes me do + lidhore, e cila, siç e kemi vënë në dukje më parë ka ekzistuar në këto të folme, është shtrirë shumë në kurriz të trajtës kam + paskajoren me *me*. Në brezin e ri me shkollë janë të gjithmbarshme trajtat: *do t'kemi, do t'shohim, do t'shkojm*, dhe hasen fare sporadikisht trajtat me kam + paskajoren.

5. Nën ndikimin e gjuhës letrare ka nisur të përdoret paskajorja e tipit *për të punuar*, trajtë e cila, simbas vëzhgimeve tona ka munguar fare në këto të folme. E kemi hasur sidomos në nxënësit e shkollës tetëvjeçare e të gjimnazit të Koplikut, çka rrefen se është ndikim kryesisht i gjuhës së teksteve e i letërsisë artistike.

6. Në shumë raste, në referate, raporte, po edhe në diskutimet në mbledhje e në përgjigjet e nxënësve në shkollë, kemi dëgjuar përcjelloren e gjuhës letrare me pjesëzën *duke: duke mos e durua gjenjen e keqe // duke fluturu, duke vendosur, duke pa, duke lexuar* etj.

7. Ka zënë të rrallohet përdorimi i paskajores së tipit *me punue* dhe po zëvendësohet nga trajtat e lidhores homonime për nga kuptimi, p.sh. *ne duhet t'shohim, për ne duhet me pa; venosen që ta nxirrin jashtë atdheut për venosen me e xierr jashtë atdheut; duhej ta ushqenin për duhej me e ushqye*, etj.

Nga sa thamë më sipër del se ndryshimet në gjuhën e fshatit janë të lidhura me ndryshimet dhe përparimet ekonomiko-shoqërore që kanë ndodhur e po ndodhin në mbarë fshatrat e vendit tonë. Zhvillimi me vull i ekonomisë dhe i kulturës socialiste në fshat, në mënyrë të veçantë përhapja e gjërë e librit (duke kuptuar këtu tekstet mësimore, letërsinë politike, artistike etj.), shtypit qendror e të rretheve, lëvizjet e përkohshme jashtë fshatit sidomos në jug, (në ushtri, aksione, shkolla, kurse etj.) dhe anasjelltas, ardhja në fshat e kuadrove dhe punonjësve të tjerë nga vise të ndryshme, ndikojnë mjaft edhe në të folurit e fshatarëve, veçanërisht në brezin e ri (përgjithësisht edhe në të mesmin).

Ndryshimi më i dukshëm sot për sot i përket fushës së leksikut; ndryshime ka edhe në fonetikë e morfologji, por ato janë më të pakta dhe bëhen më ngadalë, me më shumë luhatje e luftë trajtash.

E mbyllim këtë kumtesë duke shënuar se në kushtet e një zhvillimi të vrullshëm të paparë ndonjëherë, të nivelit të kulturës dhe të jetesës së popullsisë fshatare, në kushtet e pjesëmarrjes së saj të gjerë në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, kulturele, del e nevojshme të kihet parasysh puna për pastërtinë dhe njësimin e gjuhës. Më sipër thamë se në gjuhën e fshatit kanë hyrë e po hyjnë shumë fjalë e terma «të reja» dhe e vlerësojmë këtë si një gjë të mirë, e cila shpie në pakësimin e dallimeve nëndialektore e dialektore, por, duke e parë në prizmin e pastërtisë së gjuhës, nuk mund të mos shqetësohemi që disa fjalë të huaja të gjuhëve të tjera, në vend që të flaken fare po vërshojnë edhe në gju-

hën e fshatit, herë herë duke fituar mbi fjalët vendëse shumë të bukura. Një gjë e tillë vë përpara përgjegjësisë dhe shtron si detyrë që t'i kushtohet kujdes më i madh pastërtisë së gjuhës nga punonjësit e shtypit qendror e lokal, nga lektorët e kuadrot e ndryshëm të partisë e të pushtetit që venë në fshat dhe u takon të flasin gjerë me fshatarët. Në mënyrë të veçantë duhet të shtojnë kujdesin mësuësit dhe hartuesit e teksteve shkollore.

Konkretisht për fshatrat e Veriut (rrethi i Shkodrës) duhet ndrequr praktika e gabuar e mësuësve që janë nga qyteti i Shkodrës tek të cilët vihet re shpesh një «konservacion i ndërgegjeshëm» i trajtave nëndialektore të gropës së Shkodrës. Në një kohë kur librat kryesorë që bien në dorën e nxënësve, (tekste, broshura politike, romane, revista, gazeta, etj). botohen në gjuhën letrare, mësuësi në vend që të ngulmojë për ruajtjen e trajtave të vjetra (që dihet se nuk kanë të ardhme) duhet të bëjë përpjekje këmbëngulëse të zhvishet vetë, sa të jetë e mundur e më tepër nga këto veçori dialektore e nëndialektore, duke mos harruar se të folurit e tij ndikon shumë tek nxënësit. Gjuha e mësuësit duhet të jetë e njejtë me gjuhën e tekstit në mënyrë që të ndihmojë dhe të shpejtojë procesin e përhapjes e të ngulitjes së normave të gjuhës letrare edhe në fshat.

## R é s u m é

### MODIFICATIONS INTERVENUES ACTUELLEMENT DANS LE PARLER DES VILLAGES DE NOS REGIONS DU NORD

(d'après les observations faites dans la région de Koplik)

*D'après les observations dans la région de Koplik, district de Shkodër, Gjovalin Shkurtaç brosse, dans leurs lignes générales, les modifications intervenues dans le parler des campagnes, modifications conditionnées par le développement économique et culturel ainsi par l'influence de la langue littéraire.*

*Après avoir fait noter que les modifications les plus sensibles interviennent dans la sphère du lexique, l'auteur fait les stratifications nécessaires, mettant en vue les mots qui pénètrent dans le parler (mots nouveaux), mais aussi ceux qui tombent en désuétude (mots vieillies). Trois facteurs sont considérés pour les modifications qui interviennent dans le parler des campagnes:*

1. La langue littéraire, qui se propage au moyen des manuels scolaires, la littérature artistique, politique et scientifique, la presse et la radio.

2. La langue populaire, avec sa base le dialecte méridional, qui influe sur le parler des campagnes septentrionales au moyen du personnel venu des régions méridionales, des actionnistes, des militaires, etc., qui séjournent dans ces campagnes pendant longtemps.

3. Le parler de la ville de Shkodër, qui exerce son influence dans les campagnes au moyen des instituteurs, des médecins, des actionnistes qui travaillent dans les campagnes pendant plusieurs mois, ainsi qu'à travers les contacts qu'ont les groupes paysans avec la ville ou bien ceux de la ville avec les campagnes.

*L'auteur conclut son article, en posant la tâche d'accorder un plus grand soin à la pureté de la langue par les instituteurs et l'autre personnel qui séjournent dans les campagnes.*

